

REXHEP QOSJA

SHKRIMTARËT DHE GJUHA LETRARE

Kongreset, siç është ky, që përfundojnë ose duhet të përfundojnë me marrëveshje të përgjithshme rreth çështjeve të shtruara, i obligojnë njerëzit në radhë të parë moralisht që t'u përmbahen atyre marrëveshjeve. Meqenëse përgjegjësitë morale, mjerisht nuk përmbushen gjithmonë prej bartësve të tyre — e pohoj këtë duke pasur parasysh refuzimin e disa shkrimtarëve të Kosovës që t'i përmbahen marrëveshjes së arritur në Konsultën e drejtshkrimit, të organizuar në Prishtinë më 1968 — kam quajtur të nevojshme të them këtu pak fjalë për disa përgjegjësi të tjera të shkrimtarëve, që burojnë nga obligimet me të cilat na ngarkon ky Kongres.

Përgjegjësia gjuhësore e shkrimtarit shqiptar në këtë çast është e dyfishtë: kulturore dhe artistike. Me përgjegjësinë kulturore kuptojmë kontributin që shkrimtarët i japin përmes veprave të tyre kulturës gjuhësore kombëtare, kurse me përgjegjësinë artistike kuptojmë kontributin që i japin ata zgjerimit, thellimit dhe, në përgjithësi, pasurimit të mundësive shprehëse të gjuhës kombëtare letrare. Këto dy përgjegjësi — prej të cilave, e para u bie për barrë sidomos shkrimtarëve tanë të sotëm, kurse e dyta të gjithë shkrimtarëve të të gjitha kohëve dhe, më në fund, të të gjithë popujve — nuk janë të veçuara prej njëra-tjetrës; ato plotësohen reciprokisht dhe janë në lidhje të ngushtë dialektike. Një shkrimtar, që sot nuk do të tregojë gatishmërinë e duhur që të përqafojë përgjegjësinë kulturore gjuhësore, është fare e sigurtë se nuk do t'ia dalë të përmbushë as atë përgjegjësinë tjetër, artistike, prej së cilës shkrimtarët s'mund të jenë kurrë të shkarkuar, pavarësisht prej kujdesit që mund të kenë ndaj gjuhës së shkrimeve të tyre dhe prej prirjes me të cilën mund të jenë të pajisur. Nga ana tjetër, një shkrimtar që nuk do të përpiqet të përmbushë përgjegjësinë artistike nuk do të mund të përmbushë as përgjegjësinë kulturore, pavarësisht prej vullnetit me të cilin do ta përqafojë atë.

E para, përgjegjësia kulturore mund të quhet parimisht e plotësuar në qoftë se shkrimtari i shkruan veprat e tij në gjuhën letrare kombëtare.

E dyta, përgjegjësia artistike mund të merret e përmbushur në qoftë se shkrimtari, pasi të ketë përqaftuar të parën, përgjegjësinë kulturore, të gjitha përpjekjet e tij si krijues i shtrin në drejtim të zbatimit të saj sa më besnik dhe të shprehjes gjuhësore sa më të përsosur.

Vetvetiu kuptohet që çdo shkrimtar kujdeset të shkruajë sa më bu-

kur dhe këto përpjekje qëndrojnë në natyrën e vetë krijimtarisë, por në momentet e përgjegjësisë së shtuar kulturore gjuhësore, obligimet e shkrimtarit në këtë pikëpamje janë më të mëdha, prandaj nuk mund t'i quajë të realizuara njëkohësisht të dy përgjegjësitë në qoftë se nuk forcon vullnetin, kujdesin dhe angazhimin e vetëdijën e tij.

Në përgjithësi, shkrimtarët shqiptarë i kanë përqaftuar përgjegjësitë gjuhësore, por, në veçanti, nuk i kanë përqaftuar të gjithë: me gjuhën letrare kombëtare sot shkruajnë pjesa më e madhe e shkrimtarëve, por akoma nuk shkruajnë të gjithë. Disa prej tyre, për më tepër, nuk janë të gatshëm të shkruajnë në gjuhën letrare kombëtare, prandaj edhe në heshtje dhe me zë të hyjnë në vallen gjuhësore të shumicës. Argumenti i tyre kryesor, por, njëkohësisht mjaft naiv, me të cilin përpiqen të arësyetojnë rezistencën që i bëjnë gjuhës letrare kombëtare, prandaj edhe përgjegjësisë kulturore, mbështetet në pohimin se njëri dialekt është favorizuar në krahasim me tjetrin edhe është favorizuar në radhë të parë prej administratës. Shkrimtari, që është i gatshëm të pranojë përgjegjësinë kulturore gjuhësore kurrë nuk do të bënte pyetje të tilla, që nuk sjellin zgjidhje. Duke shikuar çështjen nga aspekti kulturor, për të nuk është e rëndësishme se cili dialekt është marrë për bazë të gjuhës letrare; për të është e rëndësishme që njërit prej tyre i ka takuar ky rol dhe se është krijuar gjuha letrare kombëtare. Ai është i vetëdijshëm se gjuha letrare e një kombi nuk mund të krijohet me mëshirën e stihisë, por në sajë të marrëveshjes kolektive, mobilizimit të vetëdijshëm të forcave shoqërore, që e bën pushteti, të aktivitetit praktik shkencor e letrar, siç është krijuar, më në fund, edhe gjuha jonë letrare kombëtare. Këtë pohim e dëshmon edhe historia e formimit të gjuhëve letrare kombëtare të popujve të tjerë të qytetëruar evropianë. Linguisti i madh, Ferdinand de Saussure, në ligjëratat e tij të njohura ka pohuar, duke pasur parasysh historinë e gjuhëve letrare të francezëve, gjermanëve dhe italianëve, sa vijon: «E lëshuar në mëshirën e fatit të vet, gjuha ruan ndarjen në dialekte, prej të cilëve asnjëri vetëvetiu nuk derdhet në tjetrin, dhe kështu mbetet e dënuar të jetë gjithmonë e copëtuar. Mirëpo, meqenëse përhapja e qytetërimit e shton komunikimin, me një marrëveshje të heshtur zgjidhet njëri prej dialekteve ekzistuese dhe ai bëhet transmetues i gjithë asaj që e intereson kombin në tërësi. Shkaqet e një zgjidhjeje të këtillë janë të ndryshme: një herë i jepet përparësi dialektit të krahinës me qytetërim më të zhvilluar; herën tjetër dialektit të krahinës që ka hegjemoninë politike dhe ku gjendet pushteti qendror; herën e tretë oborri ja imponon gjuhën e vet kombit». I shikuar nga aspekti i përgjegjësisë kulturore të shkrimtarëve si prijëtarë të proceseve pozitive kulturore, diskutimi «a posteriori» i kësaj çështjeje është i dëmshëm për zhvillimin e kulturës kombëtare. Pranimi apo mospranimi i përgjegjësisë kulturore nga ana e shkrimtarëve shtron një çështje tjetër: çështjen e ardhmërisë, domethënë të jetës aktive estetike, të komunikimit të veprave të tyre me të gjithë pjesëtarët e kombit.

Shkrimtarët që sot vazhdojnë të shkruajnë në dialekte në të vërtetë janë shkrimtarë që nuk duan të mendojnë shumë për të ardhmen e veprave të tyre, ose, më në fund, që nuk e kanë të qartë si duhet perspektivën e tyre. Në qoftë se nuk duhet dyshuar që gjuha letrare kombëtare do të bëhet me kohë edhe gjuhë e komunikimit të përditshëm

të të gjithë shqiptarëve, pavarësisht se sa i gjatë do të jetë ky proces, atëherë nuk duhet dyshuar se veprat e shkrimtarëve që nuk janë të shkruara në këtë gjuhë do të vjetrohen shumë më përpara veprave të shkrimtarëve të shkruara në të, edhe po të supozojmë që mund të jenë vlerash të njëjta artistike. Për sa i përket kësaj çështjeje, shkrimtarët që s' shkruajnë në gjuhën letrare kombëtare, do të duhej të merrnin mësim prej fatit të disa shkrimtarëve të përparshëm, veprat e të cilave sot janë vjetruar artistikisht pikërisht pse janë vjetruar gjuhësisht. Kështu, për shembull, veprat poetike të Jeronim de Radës dhe poetëve të tjerë arbëreshë kanë mbetur jashtë mundësisë së komunikimit artistik me lexuesit shqiptarë për arsye se janë shkruar në të folmen e arbëreshëve të Italisë, që sot mund ta kuptojnë vetëm pak arbëreshë të Italisë. Veprat e këtyre poetëve, praktikisht, duhet të kthehen në gjuhën e sotme letrare jo vetëm që të mund t'i shijojmë, por edhe t'i kuptojmë. Disa prej shkrimtarëve tanë, që s' duan të përfillin gjuhën letrare, mund të thonë se një fat i tillë dikur do t'i gjejë, pak a shumë, të gjitha veprat e shkrimtarëve, mbasi gjuha do të vijë duke ndryshuar, ashtu sikundër kanë ndryshuar të gjitha gjuhët e të gjithë popujve. Vjetrimi për shkaqe gjuhësore i veprave të një shkrimtari që shkruan në gjuhën letrare kombëtare, ndërkaq, është diçka tjetër në krahasim me vjetrimin e veprave të shkrimtarëve që shkruajnë në dialektet ose në disa të folme të saj. Vjetrimi gjuhësor i të parëve është një vjetrim i ngadalshëm, i së ardhmes së largët dhe, ndofta, kurrë i plotë; vjetrimi i këtyre të dytëve është një vjetrim i së ardhmes së afërt, që mbas formimit të gjuhës letrare kombëtare, bëhet edhe më i shpejtë; sa më shpejt të përhapet gjuha letrare, aq më shpejt vjen duke u vjetruar gjuha e shkrimtarëve që shkruajnë në dialekte ose të folme. Këto vepra janë të shkruara për lexuesit e një krahine, që mund t'i shijojnë gjuhësisht, dhe me inkuadrimit të tyre në orbitën e gjuhës letrare kombëtare ato mbesin dokumenta në vitrinat e bibliotekave, që i denjësojnë kohë pas kohe gjuhëtarët e rrallë me interesimin e tyre linguistik, ose historianët e letërsisë, që detyrohen t'i kthejnë në gjuhën letrare për t'ua afruar lexuesve të rinj. Ky është fati thuasjse tragjik i veprave të shkrimtarëve që i rezistojnë përgjegjësisë kulturore gjuhësore, pavarësisht prej vlerës së tyre artistike. Po çështja s' përfundon me kaq. Mund të themi që përvoja historike ka dëshmuar se shkrimtarët që qëndrojnë mënjane proceseve pozitive gjuhësore, në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme, shpeshë qëndrojnë mënjane edhe proceseve pozitive shoqërore në përgjithësi. Ky pohim mund të provohet jo vetëm me shembulla nga historia e letërsisë së Rilindjes, po edhe nga letërsia shqipe në Kosovë.

Shkrimtarët e mirë, rëndom, u përgjigjen kërkesave të kohës në të cilën jetojnë jo vetëm me problemet që mund të trajtojnë, por edhe me gjuhën në të cilën do t'i trajtojnë ato. Është e ditur se idetë vjetrohen, sot janë aktuale, po nesër bëhen anakronike, por gjuha e një shkrimtari, zakonisht, e ruan freskinë shumë gjatë në qoftë se është në pajtim me kohët e zhvillimit të gjuhës kombëtare, në qoftë se nënkupton sintezën e veçorive të veçanta dialektale në të përgjithshmen kombëtare. Të ardhmen e veprave të një shkrimtari aq sa e përcakton vlera e tyre artistike, po aq e përcakton edhe gjuha e tyre. Stilisti francez, Pjer Giro, ka thënë në veprën e tij «Stilistika» sa vijon: «Idetë janë të mira

të përgjithshme të një epoke, ndërsa stili është vetë njeriu por, se sa është origjinal një shkrimtar dhe se sa ndikon si te të tjerët shihet në ardhmërinë e gjuhës më shumë se sa në ardhmërinë e mendimeve të tij». Shkrimtarët tanë, që i rezistojnë përgjegjësisë kulturore gjuhësore, mund të jenë të sigurtë që, pavarësisht prej vlerës së mendimeve dhe të ideve, do të vjetrohen më shpejt se ç'pandehin për arsye se gjuha e tyre dialektale është sot e vjetruar.

Mos do të thotë tani kjo se ata që e përqafojnë përgjegjësinë kulturore, vetëvetiu kanë kryer plotësisht dhe me sukses misionin e tyre kulturor dhe artistik?

Krijues i vetëdijshëm dhe gjuhësisht funksional me veprat e tij nuk mund të quhet çdo shkrimtar që vetëm u përmbahet rregullave të drejtshkrimit. Shkrimtarët, më parë se gjuhëtarët, janë ata që e zhvillojnë dhe e pasurojnë gjuhën, që zgjerojnë dhe thellojnë mundësitë e saj shprehëse. Për më tepër, mund të thuhet, këtë detyrë ata nuk do të mund ta kryenin me sukses në qoftë se do t'i respektonin kërkesat e gjuhëtarëve që shpesh janë në kundërshtim me «lirinë» gjuhësore të krijuesve, Shkrimtari që, rëndom, i thyen rregullat e gjuhës dhe gjuhëtari që përpiqet t'i bëjë këto rregulla të përhershme, në një farë mënyrë gjenden në një mosmarrëveshje të përhershme: gjuhëtari është ai që e konstaton një gjendje, që prej saj nxjerr ligjësi dhe që me këto ligjësi do të ruajë atë gjendje stabile në mos dhe statike. Shkrimtari, ndërkaq, është ai që s'i respekton gjithmonë ato ligjësi dhe që dalëngadalë e ndryshon atë gjendje. Shkrimtari i mirë, pikërisht pse do të krijojë një gjendje gjuhësore dinamike, është revolucionar në gjuhë. Shkrimtari i mirë që kujdeset të shtojë thesarin gjuhësor duhet ta njohë me themel gjuhën popullore, që është burim i pashtershëm i gjuhës letrare kombëtare. Shkrimtarët e mëdhenj, prej të cilëve shumica në veprat e tyre kanë përdorur një numër të madh fjalësh, janë kujdesuar të jenë në kontakt të përhershëm me gjuhën popullore. Gjuha e Dantes, e Servantesit, e Shekspirit, e Gëtes, e Tolstoit, e Gorkit, siç kanë konstatuar biografët e tyre, është gjuhë krijuese e shkrimtarëve që kanë njohur për mrekulli gjuhën e popujve të tyre. Përkthimet dhe veprat origjinale të Fan Nolit japin të kuptohet që, megjithëse ka jetuar kryesisht nëpër vende të huaja, është frymëzuar gjithnjë prej tamës së madhe: gjuhës popullore. Shkrimtari që e njeh gjuhën popullore dhe që e ka të fortë ndjenjën e gjuhës, kujdeset ta zgjerojë fondin e vet leksikor në përgjithësi. Për këtë shkak ai kërkon fjalë te gjuha popullore dhe i nxjerr në harresë ato fjalë apo fraza të rralla, të cilat, për një arsye ose një tjetër, kanë mbetur jashtë komunikimit të përditshëm. Shkrimtari i mirë, më shumë se kaqë, pasuron gjuhën, duke zgjeruar dhe thelluar radiusin e saj operativ, jo vetëm me fjalët e nxjerra prej harrese, por edhe me terminologjinë tekniko-shkencore që gjithnjë e më shumë po hyn në përdorim.

Kontributin më të madh gjuhës kombëtare letrare, në të vërtetë, shkrimtari ja jep me krijimin e lidhjeve të reja të fjalëve, me farkimet e papritura të tyre, me zbulimin e aspekteve të reja gjuhësore. Ai i vë fjalët në pozita të reja, u krijon gjendje të reja semantike; ai, pra, bën aso manovrimesh gjuhësore që nuk i ka përjetuar gjuha përpara tij. Shkrimtari mund të jetë novator në pikëpamje gjuhësore po aq sa mund të jetë novator edhe në pikëpamje të procesit krijues, të ideve dhe formave të

reja të shprehjes. Gjuha është arma kryesore e shkrimtarit me të cilën ai i vë në qarkullim idetë, mendimet dhe emocionet, që e karakterizojnë shoqërinë e një kohe; sa më e përsosur të jetë kjo armë aq më efektivisht do të qarkullojnë këto ide, mendime dhe emocione. Shkrimtari i mirë, që e do dhe e njeh gjuhën, realizon aspekte të reja ndjenjash, bëhet pionier i asaj ndjeshmërie që populli i tij akoma s'e ka përjetuar, duke e pasuruar kështu botën e tij emocionale, jetën e tij kulturore, duke i zgjeruar njëkohësisht mundësitë e gjuhës kombëtare dhe mundësitë e jetës shpirtërore të kombit. Gjuha është treguesi më i mirë i fatit historik të një populli. Kurse shkrimtari i mirë që vetëdijen kulturore dhe vetëdijen artistike gjuhësore e ka të fortë, është pjesëmarrësi më aktiv i kësaj historie dhe, madje, njëri prej prijësve shpirtërorë të popullit. Përmes gjuhës së tij ai jo vetëm përkujton tërë popullin se cili ishte ky fat historik dje por pak a shumë cila është historia e tij e sotme dhe, pak a shumë, cila do të jetë edhe nesër. Shkrimtari i mirë, pra, edhe në këtë pikëpamje është pararojë shpirtërore e popullit të vet.

Ndikimi gjuhësor i shkrimtarit nuk mund të realizohet jashtë funksionit estetik të gjuhës në veprën letrare dhe për këtë shkak përgjegjësia e tij artistike është shumë e madhe. Në gjendjen e sotme të stabilitetit të gjuhës shqipe, shkrimtari që nuk e ka zhvilluar këtë përgjegjësi në masën e duhur, që nuk kujdeset ta shtrijë sa më tepër ndikimin pozitiv gjuhësor përmes funksionit të saj estetik, është më tepër i dëmshëm se sa i dobishëm. Në rastin më të shpeshtë, një shkrimtar i tillë e zvogëlon mundësinë e përhapjes së mendimeve, ideve, ndjenjave, e zvogëlon interesimin e lexuesve për letërsinë dhe e prish shijen e tyre. Në kohën tonë kur njerëzit kanë zënë të lexojnë më tepër se ndonjëherë në historinë tonë, kur rinia mëson çdo gjë përmes librit, kur libri mbetet akoma dritarja kryesore përmes së cilës të rinjtë e shohin dhe e njohin botën dhe shoqërinë, kur përmes librit, pra, fitojnë kulturën dhe formojnë shijen e tyre, askush nuk mund të parashohë se ç'përpjestime mund të ketë dëmi që një shkrimtar pa përgjegjësi gjuhësore i bën popullit të vet dhe kulturës kombëtare. Shkrimtari, i njohur, Kerel Çaçek, ka thënë në eseun kushtuar gjuhës çeke: «Poeti që shpreh nivelin më të lartë të gjuhës shpreh njëkohësisht nivelin më të lartë të vetëdijes nacionale. Pohoj se kjo vepër s'është më pak e dobishme se ekonomia ose ushtria kombëtare... Nuk njoh asnjë shkrimtar të mirë, i cili nuk është krijuar gjuhësor; nuk ka letërsi të mirë pa gjuhë të përsosur. Kush nuk di t'i japë gjuhës freskinë elementare ose valerin muzikor, kush nuk di t'ja japë asaj pastërtinë logjike ose ta bëjë përmbajtje konkrete, ai s'është shkrimtar; le të shkojë të shkruajë kryeartikuj gazetash ose le ta prishë populli në ndonjë mënyrë tjetër». Shkrimtarët që janë të vendosur t'i shërbejnë me nder kulturës kombëtare dhe, më në fund, popullit me armën e tyre kryesore: fjalën e shkruar, duhet të jenë gjithnjë të vetëdijshëm për përgjegjësinë gjuhësore, që është e dyfishtë. Shkrimtari mund të jetë i madh ose i çmuar jo vetvetiu, po varësisht prej lexuesve; zakonisht sa më i madh të jetë numri i lexuesve që shijojnë veprat dhe pranojnë ndikimin e tij kulturor, aq më i rëndësishëm dhe më i madh do të jetë ai. Pranimi i përgjegjësisë kulturore gjuhësore bëhet kështu një prej kushteve themelore edhe të së ardhmes artistike të krijimtarisë së shkrimtarëve tanë.

